REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 553/23
Datë/Datum. 31.10.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***09.10..2023***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***31.10.2023***	***Nr. i lëndës:*** *553/23*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.08.2023, OE “" AS Tech " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0553, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim dhe mirembajtje te klimave ne QKMF dhe njesit e saj” me nr. të prokurimit: "73350-23-6551-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE PRISHTINË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure: Kuotim i Çmimit, lloji i kontrates:, shërbim, vlera e parashikuar e kontrates: 9,999.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë B05: 27.06.2023/ Data e njoftimit për dhënie te kontratë B08: 24.07.2023, Data e njoftimit për anulimin e dhënies se kontratë B11 : 25.07.2023, data e hapjes së ofertës: 10.07.2023, data e njoftimit mbi vendimit e AK: 17.07.2023, data e njoftimit të me letër standarde:17.07.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "" AS Tech " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit

"Furnizim dhe mirëmbajtje të klimave në QKMF dhe njësit e saj" me numër të prokurimit: "73350-23-6551-2-3-6, të

iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE

2

Neni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi

1 . Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese

dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 6- Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike

dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në

konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyres së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë. Vlera e përgjithëshme monetare **për shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00**
Lista e kontratave të realizuara së bashku me referenca përkatëse,raporte (deshmi vetem te natyres perkatse Aneksi 1 DT).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PER RISHQYRTIM)

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues eshte i papërgjegjshëm
OE i rekomanduar per kontrate eshte i përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues " AS Tech " SH.P.K i pakënaqur me vendimin e AKse, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.
OE ankues me datën: 17.07.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa ne ankesën e tij ka pretendim se OE i rekomanduar për kontrate, nuk ka ofruar kontrata te natyrës se njëjtë, sipas kërkesës se dosjes se tenderit, ku AK-ja ka kërkuar:
Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyres së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë.Vlera e përgjithëshme monetare për **shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00.**
Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ankesën e tij OE ankues i konteston kontratat veq e veq për te cilat pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, nuk e arrin vlerën e kërkuar sipas dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të këresave të dosjes fillimisht konstaton se kërkesa e dosjes ka qenë shumë decidive ku përveq kërkesës për "natyrë të njëjtë" të kontratave, në fund të kërkesës ka kërkuar shprehimisht "Vlera e përgjithëshme monetare për "Vlera e përgjishtshme **shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00.**

Me qenë se qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit sipas vet dosjes së tenderit është për :

"Mirëmbajtje,furnizim me klimave për QKMF-në dhe të gjitha njesit e saj si dhe mirëmbajtja e sistemit të klimatizimit **dhe ventilimit** në QMF-Besi."

Atëher mendimi i ekspertit është se shërbime të njëjta duhet konsideruar vetëm furnizimi dhe servisimi i klimave DHE ventilimi.

Pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit, si dhe dëshmive të ofruara nga AK konkretisht paramasat e kontratave të ofruara nga OE i rekomanduar, kemi gjetur se OE Termovizion përnes kontratave me DEKOR dhe me STARBAG, arrinë shumën mbi 15,071€ në **shërbime të njëjta**, do thotë shërbime për furnizim dhe servisim të klimave dhe ventilim.

Provë: Paramasat e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë
Provë: Procesverbali i seancës për shqyrtim kryesor i datës 03.10.2023

Nga kjo llogaritje kemi përjashtuar qfardo shërbimi nga kontrata me KK Podujevë e cila ende nuk është e përfunduar.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerëojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – QKMF PRISHTINË
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues – As Tech